

# **MBROJTJA EFEKTIVE E VIKTIMAVE TË DHUNËS**

Ky manual u realizua nga WDN Albania Womens Democracy Network Albania në kuadër të projektit : “ *Konsolidimi dhe promovimi i të drejtave për viktimat e dhunës nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve për avokatët dhe juristët dhe ofrimi i rekomandimeve ligjore për reformë në fushën e dhunës me bazë gjinore me fokus të veçantë dhunës në familje* ” i cili realizohet në kuadrin e zbatimit të skemës së granteve të projektit “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, me financim nga Bashkimi Evropian dhe zbatim nga Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

**Konsolidimi dhe promovimi i të drejtave për viktimat e dhunës nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve për avokatët dhe juristët dhe ofrimi i rekomandimeve ligjore për reformë në fushën dhunës me bazë gjinore me fokus të veçantë dhunën në familje.**

**Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura jo detyrimisht shprehin opinionet e vetë programit apo mbështetësve të projektit.**

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

---

**KP**- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

**KprP**- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë

**KF**- Kodi i Familjes (Ligji nr 9062 datë 8.05.2000 i ndryshuar)  
K.Pr.Adm. Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë

**LDHF**- Ligji për Dhunën në Familje

**UMM**- Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes

**UM** - Urdhri i Mbrojtjes

**GJRRGj** - Gjykata e Rrethit Gjyqësor

**DHF**- Dhunë në Familje

**CEDAW** - Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas

**KEDNJ** - Konventa europiane të drejtave të njeriut

Konventa e Stambollit - Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje

# TABELA E PËRMBAJTJES

---

<b>LISTA E SHKURTIMEVE.....</b>	<b>3</b>
<b>TABELA E PËRMBAJTJES.....</b>	<b>4</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>6</b>
<b>HYRJE.....</b>	<b>7</b>
<b>1. PËRKUFIZIMI I DHUNËS NË FAMILJE DHE FORMAT E SAJ.....</b>	<b>8</b>
<b>2. LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR LIDHUR ME DHUNËN NË FAMILJE DHE ATË ME BAZË GJINORE .....</b>	<b>10</b>
2.1 Përkufizimet kryesore të Konventës së Stambollit .....	11
2.2 Qëllimet e Konventës.....	12
<b>3. LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR DHUNËN NË FAMILJE.....</b>	<b>14</b>
3.1 Rrethi i personave që mbrohen nga ligji.....,	15
3.2 Kush mund të paraqesë kërkesën për urdhër mbrojtje.....	15
3.3 Si paraqitet kërkesa .....	16
3.4 Si procedohet për të paraqitur kërkesën për urdhër mbrojtjeje ...	17
3.5 Afati i shqyrtimit të urdhrave të mbrojtjes .....	18
3.6 Procesi i të provuarit .....	19
3.7 Masat mbrojtëse të parashikuara nga ligji (neni 10 i ligjit 9669 dt.18.12.2005).....	21
3.8 Çfarë përmban vendimi i gjykatës.....	22
3.9 Subjektet që njoftohen për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes (neni 17/5 dhe 19/5 i ligjit) .....	24

3.10 Çfarë ndodh nëse shkelet urdhri i mbrojtjes .....24

**4. MBROJTJA E VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE ME  
MJETE JURIDIKO PENALE (KODI PENAL DHE KODI I  
PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË)..... 26**

4.1 Veprat penale të parashikuara në Kodin Penal .....26

4.2 Parashikimet e Kodit të Procedurës Penale,  
risitë e ndryshimeve ..... 35

4.3 Viktima dhe dhunuesi në raport me procesin gjyqësor ..... 39

4.4 Roli i avokatit, juristit apo gjyqtarit ..... 41

4.5 Intervistimi i viktimës .....42

**5. DHUNA NË FAMILJE NË RAPORT ME NENIN 2 TË  
KONVENTËS EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE  
JURISPRUDENCËN E GJYKATËS EUROPIANE TË TË  
DREJTAVE TË NJERIUT NË STRASBURG ..... 44**

**ANEKS 1 ..... 49**

**ANEKS 2 ..... 55**

**LITERATURA DHE BAZA LIGJORE ..... 60**

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

---

Ky manual është hartuar si një udhëzues i përgjithshëm për juristët dhe avokatët për përfaqësimin efektiv ligjor të viktimave të dhunës me fokus të veçantë viktimat e dhunës në familje. Manuali është hartuar në pesë pjesë, në të cilat jepen njohuritë praktike bazuar në aktet kryesore të legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar. Ky manual vjen në një kohë kur dhuna në familje në Shqipëri është mjaft e përhapur dhe kur numri i denoncimeve nga viktimat e dhunës në familje është rritur në shifra të konsiderueshme. Ne shpresojmë që ky manual t'u vijë në ndihmë juristëve dhe avokatëve që kanë një rol kyç në mbrojtjen e viktimave të dhunës. Manuali përbëhet nga 4 pjesë kryesore, dhe shtojca në të cilat jepen njohuri praktike bazuar në ligjet aktuale që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria në lidhje me trajtimin e viktimave dhe situatave të ndryshme të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Manuali është hartuar në mënyrë që të ndiqet lehtësisht nga avokatët, juristët apo punonjësit e organizatave joqeveritare, të cilët gjejnë aty të pasqyruar hapat që duhet të ndiqen në bazë të legjislacionit në dispozicion në mënyrë që t'i shërbehet në mënyrë sa më profesionale viktimave të dhunës.

## HYRJE

---

Dhuna në familje dhe sidomos ajo me bazë gjinore ka marrë përmasa shqetësuese në shoqërinë shqiptare. Bazuar në të dhënat zyrtare nga Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, ka një tendencë rritjeje të rasteve të raportuara të dhunës në familje në polici, sidomos pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Dhunën në Familje.

Në shumë raste dhuna nuk raportohet dhe arsyt e mosraportimit të dhunës janë të ndryshme, si: frika e viktimave nga shtimi i mundshëm i dhunës apo pasoja të tjera të denoncimit për shkak të hakmarrjes, mungesës së besimit, ndjenjes së turpits nga shoqëria dhe komuniteti, pasigurisë dhe mungesës së konfidencialitetit nga strukturat referuese, varësia psiko sociale me dhunuesin, mendësia arkaike e shoqërisë që shpesh e pranon dhunën si të mirëqënë.

Prandaj, është thelbësore të kuptohet që statistikatat e raportuara të dhunës nuk tregojnë realisht nivelin e dhunës në vendin tonë dhe duhen konsideruar disa herë më të larta sesa niveli aktual i raportimit. Edhe pse gjatë viteve të fundit është zhvilluar një veprimtari mjaft aktive sidomos nga shoqëria civile, është zhvilluar shumë punë ndërgjegjësuere për të trajtuar dhunën në familje si një çështje të të drejtave të njeriut dhe të shëndetit publik dhe jo me si një çështje private, akoma ka nevojë për shumë punë ndërgjegjesuese dhe parandaluese. Nga ana tjetër nevojitet që të gjitha institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe adresimin e këtij fenomeni të angazhohen maksimalisht, duke punuar në bazë të legjisllacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar për të mbrojtur maksimalisht dhe me efikasitet viktimat e dhunës.

# 1. PËRKUFIZIMI I DHUNËS NË FAMILJE DHE FORMAT E SAJ

---

Ligji e përcakton dhunën në familje si çdo formë abuzimi e ushtruar nga një person ndaj një personi tjetër, e cila rezulton në dhunim të integritetit të tij fizik, moral, psikologjik, seksual, social ose ekonomik. Abuzimi mund të ndodhë në çdo kohë gjatë një marrëdhënieje, përfshirë edhe kohën gjatë së cilës kjo marrëdhënie po mbaron, ose edhe pasi ajo ka përfunduar. Kjo lloj dhune nuk njih asnjë mjedis kulturor, etnik, arsimor, apo ekonomik. Partnerët abuzivë mund të përdorin një sërë taktikash të ndryshme në përpjekje për të ushtruar pushtet dhe kontroll mbi viktimat e tyre. Abuzimi mund të ndodhë një herë, ose mund të ndodhë me një model të përsëritur dhe të përshkallëzuar gjatë një periudhe prej muajsh apo vitesh. Me kalimin e kohës gjithashtu mund të ndërrojë edhe formë. Ka disa forma të ndryshme dhune në familje, dhe një person mund të jetë subjekt i më shumë se një forme.

**Abuzimi fizik** mund të konsistojë në një incident të vetëm ose mund të ndodhë në mënyrë të përsëritur. Përfshin përdorimin e forcës fizike në mënyrë të atillë që lëndon dikë – ose e vë atë person në rrezik lëndimi – përfshirë rrahje, goditje, shkundje, shtyrje, mbytje, kafshime, djegie, shkelmime, ose sulme me armë. Forma të tjera të abuzimit fizik mund të përfshijnë izolim ose çdo përdorim tjetër të rrezikshëm apo të dëmshëm force ose shtrëngimi.

**Abuzimi dhe shfrytëzimi seksual** përfshijnë të gjitha format e agresionit seksual, ngacmimit seksual ose shfrytëzimit seksual. Të detyrosh dikë që të marrë pjesë në veprimtari seksuale të padëshiruar, të pasigurt ose degraduese, ose përdorimi i taktikave poshtëruese ose të tjera për të ulur, kontrolluar ose kufizuar



seksualitetin e personave ose zgjedhjet e riprodhimit përbën abuzim seksual.

**Abuzimi emocional** përfshin sulme verbale, si bërtitje, këllhitje, fyerje (etiketime), izolim nga shoqëria, ose frikësim. Kanosje për dhunë dhe për marrje të fëmijëve janë taktika mjaft të përhapura të përdorura nga dhunuesit, si dhe dëmtimi i zotërimeve apo kafshëve të viktimës.

**Abuzimi ekonomikose financiar** përfshin vjedhjen ose mashtrimin e partnerit. Mosdhënia e parave që janë të domosdoshme për të blerë ushqim apo trajtim mjekësor, shfrytëzimi i një personi për përfitim financiar, mohimi i aksesit për burime financiare, ose pengimi i një partneri që të punojë janë gjithashtu forma të abuzimit ekonomik.

## **2. LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR LIDHUR ME DHUNËN NË FAMILJE DHE ATË ME BAZË GJINORE**

---

Organizatat ndërkombëtare si OKB dhe Këshilli i Europës kanë përpunuar përgjatë viteve akte të shumta të cilat kanë synuar mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga dhuna dhe diskriminimi. Një listë e këtyre konventave, të cilat janë ratifikuar edhe nga parlamenti shqiptar janë:

Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas (CEDAW)

Konventa mbi të drejtat e fëmijës e OKB

Konventa europiane të drejtave të njeriut (KEDNJ)

Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual.

Por një vend të rëndësishëm në radhën e këtyre akteve ndërkombëtare ze Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje **(Konventa e Stambollit- 11.5.2011)**

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është traktati më i përparuar ndërkombëtar për të trajtuar te tilla shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Konventa synon të sigurojë tolerancë zero për këtë lloj dhune dhe është një hap i madh përpara për ta bërë Evropën më të sigurt.

Parandalimi i dhunës, mbrojtja e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve janë gurët e themeleve të kësaj konvente. Ajo synon gjithashtu të ndryshojë mendësitë e individëve duke iu bërë thirrje pjesëtarëve të shoqërisë, në veçanti burrave dhe djemve, të ndryshojnë sjellje. Në thelb, konventa është një thirrje e re për

barazi ndërmjet burrave dhe grave, pasi dhuna ndaj grave i ka rrënjët thellë në pabarazinë shoqërore dhe ka vijuar për shkak të kulturës të mostolerancës dhe mohimit.

Konventa e njeh dhunën ndaj grave si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si formë diskriminimi. Kjo do të thotë që shtetet kanë përgjegjësi nëse nuk i përgjigjen në mënyrën e duhur kësaj dhune. Konventa është traktati i parë ndërkombëtar që përmban një përkufizim të gjinisë. Kjo do të thotë që tashmë njihet që gratë dhe burrat nuk janë thjesht qenie biologjike femërore apo mashkullore, por që ekziston një kategori sociale e gjinisë që përcakton rolet dhe sjelljet e grave dhe burrave. Rezultatet e kërkimeve tregojnë se disa role dhe sjellje të caktuara mund të kontribuojnë në inkurajimin e dhunës kundër grave.

Konventa kriminalizon vepra të tilla si: gjymtimin gjinor, martesën e detyruar, përndjekjen, abortin dhe sterilizimin e detyruar. Kjo do të thotë që shtetet do të detyrohen, për herë të parë të përfshijnë këto vepra penale në sistemet e tyre ligjore.

Konventa bën thirrje për përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe shërbimeve përkatëse shtetërore, në një qasje të koordinuar të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Kjo do të thotë që institucionet dhe organizatat jo-qeveritare nuk duhet të veprojnë vetëm, por të punojnë së bashku për të përpiluar protokolle bashkëpunimi.

## **2.1 Përkufizimet kryesore të Konventës së Stambollit**

“Dhuna kundër grave” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë,

duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private;

“dhunë në familje” nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën;

“gjini” nënkupton rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë;

“dhunë gjinore kundër grave” nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale;

“viktimë” nënkupton çdo person fizik që i nënshtrohet sjelljes së përcaktuar në pikat a dhe b;

“gra” përfshin vajzat nën moshën 18 vjeç.

## **2.2 Qëllimet e kësaj Konvente janë:**

- a) mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës, dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
- b) kontributi ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave, duke përfshirë mënyrat me anë të fuqizimit të grave;
- c) hartimi i një kuadri gjithëpërfshirës politikash dhe masash

për mbrojtjen dhe ndihmën për të gjitha viktimat e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

- d) nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synim eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
- e) ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përfaqëse të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.

### **3. LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR DHUNËN NË FAMILJE**

Në dhjetor 2006, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (ligji kundër dhunës në familje) i cili ka pësuar dy ndryshime, më i rëndësishmi është ai i vitit 2010.

Qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjitha format e saj dhe të mbrojë viktimat e saj. Sipas këtij ligji, gjykatat civile mund të vendosin masa mbrojtjeje për viktimat përmes një procedure të shpejtë, të përbalueshme dhe të thjeshtë.

Megjithëse ligji tashmë është përforcuar dhe përcakton që dhuna në familje është e gabuar dhe kategorikisht e papranueshme, dhuna në familje ende mund të konsiderohet nga disa, fatkeqësisht, si një "çështje private familjare". Përveç urdhërave mbrojtës si mjete civile për t'u mbrojtur nga dhuna, tashmë ekziston mundësia për të nisur edhe një procedim penal ndaj dhunuesit. Pas ndryshimeve në Kodin Penal, dhuna në marrëdhëniet familjare, keqtrajtimi i të miturve si dhe përndjekja nga persona që kanë pasur apo kanë lidhje shpirtërore me viktimën e dhunës përbëjnë vepra të posaçme penale.

Aktualisht, në maj 2018, Këshilli i Ministrave ka miratuar një projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, ku ndër të tjera synohet zgjerimi i rrethit të subjekteve të ligjit duke përfshirë këtu edhe marrëdhëniet afektive (përveç marrëdhënieve bashkëshortore dhe atyre të bashkëjetesës). Ky projektligj është dërguar në Kuvendin e Shqipërisë dhe po i nënshtrohet procedurave parlamentare të diskutimit dhe më pas miratimit të tij.

### **3.1 Rrethi i personave që mbrohen nga ligji**

Neni 3/3 i Ligjit Nr.9669 Dt.18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" parashikon se: Pjesëtarë të familjes janë:

a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/sja apo ish - bashkëshorti/ja ose ish partneri/ja bashkëjetues.

b) vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijet e adoptuar.

c) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/sja i personave të parashikuara në shkronjën "b".

ç) gjinia në vijë të drejtë përfshirë edhe prindërit, edhe femijët adoptues të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es

d) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit

dh) fëmijet e bashkëshorteve apo partnerëve bashkëjetues.

Neni 3/3 pika " d" përfshin vëllezërit e motrat e bashkëshortit që kanë bashkëjetuar 3 vitet e fundit.

### **3.2 Kush mund të paraqesë kërkesën për urdhër mbrojtje**

Neni 13 i ligjit 9669 dt.18.12.2006 parashikon;

1. Kërkesën për urdhër mbrojtje mund ta paraqesin:

a) vetë viktimia

b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i tij

c) policia / prokuroria

2. Kërkesën për urdhër mbrojtje të një të mituri mund ta paraqesin:

a) prindi ose kujdestari i të miturit

b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës

c) të afërmit

ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimia,

që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës.

- d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje të licensuara

### **3. Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtje mund ta paraqesin:**

- a) vetë viktimia
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i tij
- c) policia / prokuroria
- d) personi me të cilin personi ka lidhje familjare
- e) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimia, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës.
- f) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje të licensuara

Të gjitha institucionet apo personat që kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për urdhër mbrojtje sipas këtij neni, e paraqesin padinë në emër dhe për llogari të viktimës, që do të thotë se paditës është viktimia.

### **3.3 Si paraqitet kërkesa**

**a. Kërkesa mund të paraqitet drejtpërdrejt në gjykatë me anë të kërkesë padisë të hartuar nga një avokat, por në praktikë janë shumë të rralla rastet kur kërkesë padia është hartuar nga një avokat, kjo për shkak dhe të kushteve ekonomike të viktimave të dhunës në familje, por sipas ligjit për mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, për hartimin e kërkesë-padisë, përgatitjen e akteve dhe paraqitjen e tyre në gjykatë, kërkuesi asistohet nga një avokat falas**



## **b. Komisariati i Policisë.**

Në praktikë plotësohen kërkesë – padi tip dhe si palë paditëse në gjykim është vetë viktimja. Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisariatit më të afërt të policisë dhe punonjësi i policisë vepron në përputhje me ligjin “Për Policinë e Shtetit” (neni 14/2)

## **c. Prokurori**

Situata kur prokurori mund të përfshihet në kërkesën për urdhër mbrojtje është kur ai po ndjek një çështje penale të kësaj familje dhe konstaton se ka elemente të dhunës në familje dhe që duhet të parandalohet me anë të urdhrit të mbrojtjes.

## **3.4 Si procedohet për të paraqitur kërkesën për urdhër mbrojtjeje**

Viktima e dhunës në familje bën denoncimin për dhunën e ushtruar nëpërmjet formave të cituara më sipër.

Rasti më i shpeshtë në praktikë është kur denoncimi kryhet në komisariatit e policisë. Kur bëhet fjalë për dhunën që është duke u ushtruar, viktimat në momentin e kryerjes së dhunës, në kohë reale, njoftojnë policinë me anë të numrit pa pagesë 129.

Në këtë rast, punonjësit e policisë, pasi marrin deklaratimet e viktimës, të dhunuesit, kur ka mundësi, si dhe të personave të tjerë dëshmitarë apo që dëshirojnë të japin shpjegime për rastin, (zakonisht familjarë) plotësojnë kërkesë padinë tip për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, dhe e depozitojnë në gjykatë menjëherë, zakonisht brenda 24 orëve, duke e shoqëruar me deklaratimet e marra.

Në rastet kur dhuna nuk ka qenë e ushtruar në moment, por e shtrire në kohë dhe nuk ka emergjencë në marrjen e masave mbrojtëse,

viktimat mund të bëjnë denoncimin në Komisarjatin e policisë apo në format e tjera që shqyrtoam më lart, duke kërkuar lëshimin e UM-urdhrit të mbrojtjes.

### **3.5 Afati i shqyrtimit të urdhrave të mbrojtjes.**

Për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes gjykata duhet të vendosë lidhur me kërkesën brenda 48 orëve pas paraqitjes së kërkesë padisë (neni 18 i ligjit)

Nëse është i mituri si palë paditëse, gjykata duhet të vendosë lidhur me kërkesën brenda 24 orëve.

Pas përfundimit të seancës gjyqësore për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata cakton datën e seancës për vërtetimin e UMM-urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila duhet të jetë brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate (neni 19/2/d).

Çështja gjykohet sipas rregullave të përgjithshme procedurale dhe nuk është e kufizuar në kohë.

- Për UM-urdhrin e mbrojtjes gjykata duhet të vendosë për shqyrtimin e kërkesës brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesë padisë (neni 16 i ligjit).

Çështja gjykohet sipas rregullave të përgjithshme procedurale dhe nuk është e kufizuar në kohë.

### **Problematikat e hasura lidhur me njoftimet**

Problematikat e vërejtura lidhen me pamundësinë e njoftimit të palës së paditur brenda 48 orëve për shkak të mungesës së sistemit të saktë e të përditësuar të adresave në Shqipëri, si dhe për shkak të mungesës së një numri kontakti në kërkesë padinë e paraqitur. Theksojmë se praktika ka ecur me frymën e ligjit

dhe është proceduar që në fazën e parë me lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, dhe, për shkak të natyrës së vendimit, ka vazhduar gjykimi në mungesë të të paditurit edhe pse nuk ka njoftim të rregullt për seancë gjyqësore.

### **3.6 Procesi i të provuarit**

Neni 15 i ligjit 9669 dt.18.12.2006 parashikon:

1. Provat që duhet t'i paraqiten gjykatës mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt – ekspertimi, ekzaminime/ pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga persona juridike (OJF) të regjistruara sipas ligjit.
  2. Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisarati i policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkresore lidhur me ushtrimin e dhunës, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar për këtë, në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose nga vetë gjykata. Në rast të moslëshimit të dokumentit të mësipërm, personat përgjegjës mbajnë përgjegjësi ligjore sipas K.Pr.Adm.
  3. Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.
- Ligji ka zgjidhur vështiresinë e procesit të të provuarit në këto lloj gjykimesh, duke parashikuar që gjykata e mbështet vendimin e saj në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve, duke u bazuar në bindjen e vet. Në praktikë ka vëshiresi në marrjen e provave në organet ku ato ndodhen dhe paraqitjen e tyre që në seancat e para, për shkak të burokracisë, gjë që bëhet shkak për zvarritjen e gjykimit. Duke pasur parasysh specifikën e gjykimit, për viktimën e dhunës në

familje, kjo gjë është mjaft e dëmshme edhe për anën psikologjike. Në udhrat e menjëhershëm të mbrojtjes është objektivisht e pamundur që gjykata të kërkojë zyrtarisht këto prova pranë institucioneve ku ato ndodhen, pasi gjykimi duhet të përfundojë brenda 48 orëve.

**-Duhet të verifikohet nëse është lëshuar një urdhër arresti për dhunuesin,** apo është marrë masë sigurimi personal ndaj tij. Ndodh që të gjykohet edhe urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes dhe masa e sigurimit personal të tij në të njëjtën ditë.

Zakonisht vihemi në dijeni të këtij fakti nga vetë viktimat e dhunës, por është e pamundur objektivisht që të merret si provë vendimi i masës së sigurimit në udhrat e menjëhershëm të mbrojtjes.

**-Verifikohet nëse ka pasur urdhra të tjerë mbrojtje** për këto palë të cilat na vihen në dispozicion nga vetë palët.

**-Dëshmitarët** zakonisht janë familjarë të të dy palëve, prandaj avokatët duhet të jenë të kujdeshëm të konsiderojnë edhe të drejtën që kanë për të zgjedhur që të mos dëshmojnë.

**-Aktet e ekspertimit.**

**-Fotografi, mesazhe telefonike, incizime, komunikime nga rrjetet sociale .**

Në praktikë marrja e këtyre provave bëhet kur të dy palët e konfirmojnë vërtetësinë e tyre, në të kundërt, ato mund të bëhen objekt kundërshtimi nga pala tjetër për vërtetësinë e tyre dhe mund të kërkojë akt ekspertimi i fushës përkatëse ( neni 258 e vijues, 278 e vijuesi K.Pr.Civile) që sjell si pasojë shpenzime dhe zvarritje të gjykimit.

**Ruajtja e sekretit** është mjaft e rëndësishme për një viktimë të dhunës. Nga intervistimet që ka kryer WDN Albania me viktimë

të dhunës është vënë re së shumë viktime nuk kërkojnë ndihmë pikërisht se kane frikë që gjithcka do të bëhet publike. Gjykata, por në veçanti juristët, avokatët, prokurorët dhe punonjësit e policisë duhet të kenë parasysh të gjithë kuadrin ligjor për ruajtjen e sekretit. (Neni 59, 159, 282, 289 K.Pr.Penale, neni 235 i K.Pr.Civile, ligji specifik) Në gjykatë është krijuar infrastruktura përkatëse dhe tashmë është e detyrueshme anonimizimi i vendimeve gjyqësore në përgjithësi dhe në veçanti ato pjesë të vendimit që kanë të bëjnë me fakte dhe rrethana personale.

Në këtë rast dhuna duhet që të jetë e tillë që paraqet kërcënim të drejtëpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës (neni 17 dhe 19 i ligjit).

### **3.7 Masat mbrojtëse të parashikuara nga ligji (neni 10 i ligjit 9669 dt.18.12.2005)**

#### **Masa parandaluese të dhunës.**

Duke urdhëruar që i padituri të mos kryejë ose të mos kërcenojë se do të kryejë vepër dhune në familje ndaj paditëses.

Duke urdhëruar që i padituri të mos cënojë, ngacmojë, kontaktojë apo komunikojë drejtëpërdrejtë apo tërthorazi me paditësen

Duke urdhëruar që i padituri të mos i afrohet paditëses përtej një distance te caktuar.

Duke urdhëruar që i padituri të mos lejohet të afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes e origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm apo personave të tjerë, shkollës e fëmijëve ose vendeve që frekuentohen me tepër nga viktime, për përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune.

Duke urdhëruar që i padituri të mos hyjë e të mos qëndrojë në

banesën e përkohshme apo të përhershme të viktimës ose në ndonjë pjesë të saj, pavaresisht nga të drejtat e pronësisë apo posedimit të dhunuesit.

Duke larguar të paditurin nga banesa për një afat të caktuar dhe duke mos lejuar rihyrjen pa autorizimin e gjykatës.

### **Masa lidhur me dhunuesin duke kufizuar disa nga të drejtat e tij.**

Kufizim ose ndalim i të paditurit për t'u takuar me fëmijet e viktimës.

Kalimi tek viktima i të drejtës së kujdestarisë të përkohshme mbi fëmijët dhe duke i hequr përkohësisht përgjegjësinë prindërore të paditurit.

Në praktikë ka vështirësi, sepse për të vendosur lidhur me këto fakte, duhet të merret mendimi i një psikologu, i cili nuk mund të përballohet nga palët në gjykim, palë të cilat shpesh janë në kushte të vështira ekonomike e sociale.

Kur urdhri i mbrojtjes ndikon në çështje që kanë të bëjnë me Kodin e Familjes, apo kur gjykohen paralel me gjykimin e zgjidhjes së martesës, mund të krijohen mbivendosje lidhur me urdhërimet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë prindërore, të drejtën e takimit, detyrimin ushqimor etj.

Kur ka ndryshime midis tyre, meqenëse urdhri i mbrojtjes ka lidhje me sigurinë e viktimave të dhunës, ai ka përparësi mbi vendimet e tjera të bazuar në Kodin e Familjes.

### **3.8 Çfarë përmban vendimi i gjykatës**

#### **Vendimi për urdhrat e mbrojtjes përmban (neni 17/3 i ligjit)**

- Masat e caktuara nga gjykata.
- Kohëzgjatjen e masës.
- Njoftimin që shkelja e urdhrit të mbrojtjes përbën veprë penale në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal.

- Të drejtën e ankimit brenda 15 ditëve.

**Vendimi për urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes (neni 19/3 i ligjit) përmban edhe :**

- Kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes i vendosur nga gjykata.
- Të drejtën e ankimit brenda 5 ditëve.
- Datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrit të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve nga lëshimi i vendimit të gjykatës.

Në praktikë organet zbatuese nënkuptojnë që efektet e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes janë deri në datën që gjykata ka caktuar për vërtetimin e urdhrit të mbrojtjes. Në fakt ligji e thotë qartë që ajo ka efekt derisa të merret vendimi për verifikimin ose jo të tij.

Vendimet e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes janë të formës së prerë dhe përbëjnë titull ekzekutiv (neni 19/6 i ligjit).

Për urdhrat e zakonshëm të mbrojtjes nuk parashikohet shprehimisht në ligj që përbëjnë titull ekzekutiv, që nënkupton se bëhen titull ekzekutiv sipas rregullave të përgjithshme, kur vendimi merr formë të prerë. Në praktikë, për vendimet e urdhrave të zakonshëm të mbrojtjes, edhe pse nuk kanë marrë formë të prerë ato lëshohen nga gjykata njëjloj si urdhrat e menjëhershëm dhe zbatohen nga organet përkatëse zbatuese. Ka disa praktika në lidhje me vendimin e urdhrit të ekzekutimit për urdhrat e mbrojtjes. Para ndryshimeve të K.Pr. Civile kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, lëshohej me kërkesë të palës së interesuar.

**Me ndryshimet e këtij Kodi, urdhri i ekzekutimit lëshohet së bashku me vendimin përkatës.**

Në praktikë ka gjyqtare që lëshojnë një vendim të veçantë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për urdhrat e menjëhershëm apo të zakonshëm të mbrojtjes.

Ka gjyqtarë që duke shprehur në dispozitivin e vendimit që ky vendim përbën titull ekzekutiv, e nënkuptojnë vendimin e urdhrit të ekzekutimit dhe nuk lëshojnë një vendim më vete.

### **3.9 Subjektet që njoftohen për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes (neni 17/5 dhe 19/5 i ligjit)**

Gjykata brenda 24 oreve pas lëshimit të vendimit u dërgon një kopje të tij:

- Viktimës dhe personave të shënuar në vendim.
- Kërkuesve në kuptim të nenit 13 të ligjit.
- Zyrës së shërbimeve sociale të njësive vendore ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat apo personat e përmendur në vendim
- Komisarariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat apo personat e përmendur në vendim.

Kjo procedurë kryhet në mënyrë që organet zbatuese të kenë një bazë të dhënash dhe që efektivat e policisë, prokurorët, OPGJ të kenë dijeni për ekzistencën e një urdhri, për një mbrojtje me të mirë të viktimës.

### **3.10 Çfarë ndodh nëse shkelet urdhri i mbrojtjes**

**Mos zbatimi i një urdhri mbrojtje apo një urdhri të menjëherëshëm mbrojtje përbën veprë penale sipas nenit 320 të kodit penal (2016) për pasojë autori i dhunës mund të arrestohet pa mandat arresti.**

Nëse dhunuesi shkel, ndërhyr apo pengon zbatimin e masave mbrojtëse mund të bëhet kallzim në komisariatin e policisë apo prokurori dhe mund të fillojë procedimi penal për shkelje të nenit



320 të Kodit Penal (pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës) si dhe procedimin penal për sa i përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepra të tjera penale sipas neneve përkatëse të Kodit Penal.

Nëse dhunuesi ka kryer një vepër penale, justifikimi që nuk ishte në gjendje të kontrollonte veprimet e tij, nuk shërben për lirimin nga përgjegjësia penale. (neni 17 i K.Penal).

Në rastet kur personi diagnostikohet me një çrregullim apo turbullim psikik apo neuro - psikik merret parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit, por jo të fajit.

Edhe kur personi ka kryer vepren penale në gjendje të dehur nuk përjashtohet nga përgjegjësia penale (neni18)

Vepra penale konkrete, e kryer në familje, shërben si rrethanë rënduese në caktimin e masës së dënimit (neni 50 i Kodit Penal).

Po kështu kur vepra penale është kryer ndaj fëmijeve, grave shtatëzana ose personave që për shkaqe të ndryshme nuk mund të mbrohen, apo është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare, konsiderohet e kryer në rrethana rënduese.

## **4. MBROJTJA E VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE ME MJETE JURIDIKO PENALE (KODI PENAL DHE KODI I PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË)**

---

### **4.1 Veprat penale të parashikuara në Kodin Penal**

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ka pësuar disa ndryshime të rëndësishme në vitet 2012-2013. Mes tyre duhet të përmendim parashikimin e një vepre penale të veçantë siç është Dhuna në familje (neni 130/1) si dhe parashikimi i dhunës në familje si rrethanë rënduese për caktimin e dënimit (neni 50 e/1). Gjithashtu me një nen të veçantë është parashikuar si vepër penale dhuna seksuale (neni 107/a).

Më poshtë sillen veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal të cilat lidhen drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë me dhunën në familje. Duhet theksuar se secila prej veprave të mëposhtme, e kryer ndërmjet anëtarëve të familjes, mund të konsiderohet dhunë në familje.

#### **Neni 130/a**

Dhuna në familje (Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 17; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 33)

**Rrahja**, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet.

**Kanosja** serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

**Plagosja e kryer me dashje**, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

**Neni 121** Ndërhyrje të padrejta në jetën private

Vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, dëgjimi, regjistrimi ose transmetimi i fjalëve, fiksimi, regjistrimi ose transmetimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim apo publikimi i këtyre të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit pa pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

**Neni 121/a** Përndjekja (Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 15)

**Kërcënimi ose ngacmimi** i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t'i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë.

Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t'u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë.

### **Neni 100**

Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur (Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 15; ndryshuar fjalët në paragrafin e dytë dhe të tretë me ligjin nr.144, date 2.5.2013, neni 20)

**Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur**, që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet, dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm

**Neni 101** Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur

të moshës 14-18 vjeç (Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 16) Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, me dhunë, me fëmijë të mitur në moshën katërbëdhjetë gjer në

tetëmbëdhjetë vjeç dhe që ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale, me dhunë, kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet.

### **Neni 102**

Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura (Ndryshuar paragrafi i I, II me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001 dhe neni 17; ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 21)

Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

### **Neni 102/a**

Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur (Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 18; ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 10) Kryerja e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.

Kur marrëdhënia homoseksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarit i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në

dhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

**Neni 103** Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur (Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 19)

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, duke përfituar nga pazotësia fizike ose mendore e personit të dëmtuar ose, nga vendosja në gjendje të pandërgjegjshme, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur personit të dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e personit të dëmtuar dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

#### **Neni 104**

Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës (Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 20) Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, duke kërcënuar personin e dëmtuar për përdorim aty për aty të armës, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

#### **Neni 105**

Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën (Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 21) Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar marrëdhëniet e varësisë ose të detyrës, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Neni 106 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari (Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 22) Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimit, dënohet me burgim gjër në shtatë vjet.

### **Neni 107**

Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike (Shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 23; shtuar neni 107/a me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 22) Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në vende publike ose në ambiente të ekspozuara nga vështrimi i njerëzve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

**Neni 107/a** Dhuna seksuale. Ushtrimi i dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve të moshës katërbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet. Kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet.

## **Neni 108**

Vepra të turpshme (Ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 24; ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 11; shtuar paragrafët me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 23;

Kryerja e veprave të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën katërbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç, me të cilin autori ka marrëdhënie familjare, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet. Përfshirja e qëllimshme si dëshmitar, në veprime me natyrë seksuale, e një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo i një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Propozimi i bërë nga një i rritur, me çdo mjet ose formë, për të takuar një të mitur që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, me qëllim kryerjen e ndonjëres nga veprat penale të parashikuara në këtë seksion apo në seksionin VIII të kreut II të këtij Kodi, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

**Neni 108/a** Ngacmimi seksual (Shtuar neni 108/a me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 24)

Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.



### **Neni 93** Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas

Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas, veç rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

### **Neni 94**

Ndërprerja e shtatzënisë e kryer në vende dhe nga persona të paautorizuar

Ndërprerja e shtatzënisë e kryer jo në ambiente spitalore publike apo klinika private të lejuara posaçërisht, ose nga një person që nuk është mjek ose, tej kohës së lejueshme për ndërprerje veç rastit kur kjo diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Kur nga vepra është shkaktuar rrezikimi i jetës ose vdekja, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

### **Neni 95**

Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzënisë

Dhënia e mjeteve që shërbejnë për ndërprerjen e shtatzënisë një gruaje me qëllim që kjo të kryejë vetë ose me ndihmën e ndonjë tjetri ndërprerje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në 1 vit. Aborti lejohet deri në javën e 12 të shtatzanisë dhe deri në javën e 22 të shtatzanisë për arsye mjekësore. Personeli mjekësor duhet të informojë gruan që:

-Rrezikohet shëndeti

-Të drejtën e saj ligjore për të hequr dorë nga përfundimi i shtatzënisë.

-Institucioni duhet të ofrojë mbështetje financiare dhe psiko – sociale.

-Klinikat dhe spitalet ku mund të bejë përfundimin e shtatëzanise.  
-Një aprovim me shkrim  
Shkelja e këtyre rregullave shkakton dënim deri në 5 vjet burg.

### **Neni 130 (Martesa e detyruar)**

Shtrëngimi apo pengimi për të bashkëjetuar ose për të lidhur apo zgjidhur martesë (Ndryshuar me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 32) Shtrëngimi apo pengimi për të filluar ose vazhduar bashkëjetesën, ose shtrëngimi për të lidhur apo zgjidhur martesën, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj. Kërkesa e qëllimshme ndaj një të rrituri ose fëmije për të shkuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim detyrimin e tij për të lidhur martesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Neni 28 i Kodit të Familjes parashikon që martesa lidhet publikisht para nëpunësit të gjendjes civile të cilit i është paraqitur kërkesa për shpallje. Neni 33 i Kodit të Familjes parashikon se martesa e lidhur pa pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve ose njërit prej tyre është e pavlefshme.

- Për një martesë të detyruar përdoret presion, dhunë e abuzim me pushtetin. Mjetet e dhunës dhe të presionit janë si fizike dhe psikologjike, si dhe nëpërmjet kërcënimeve.
- Edhe martesat e lidhura për efekt të përfitimeve nga procedurat e emigracionit, pa qëllimin e bashkëjetesës, mund të përbëjë një martesë të lidhur me detyrim ose forcë.

Gjykata dhe avokatët duhet të ketë parasysh dhe rastet kur kërkohet të lejohet martesa përpara moshës 18 vjeç, sipas nenit 7 të Kodit të Familjes, pasi pas këtyre martesave mund të fshihet një martesë e detyruar.

Gjykata duhet të ketë parasysh se të miturat janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe më të ekspozuara ndaj rrezikut për martesë fiktive, apo premtimeve për martesë, të cilat mund të përfundojnë në shfrytëzim prostitucioni apo trafikim.

- Edhe martesat me mblesëri apo ndërmjetësi janë rrezik për respektimin e parimit të “Pëlqimit të lirë” në lidhjen e martesës. Parimi i “Pëlqimit të lirë” në lidhjen e martesës është i mbrojtur si nga legjislati i ndërkombëtar dhe legjislati i brendshëm.

Neni 12 i KEDNJ parashikon se duke filluar nga mosha e lejuar për martesë, burri dhe gruaja kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë një familje sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte. Kjo e drejtë mbrohet gjithashtu dhe nga Konventa e Stambollit e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë. Edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 53/1 të parashikon ‘Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje.

Neni 8 i K.Familjes parashikon parimin e pëlqimit të bashkëshortëve. Neni 44 i K.Familjes parashikon të drejtën e ngritjes së padisë për martesë të lidhur pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve, ose njërit prej tyre, kur martesë është lidhur me kanosje apo lajthim.

E drejta e parashkrimit të padisë është brenda gjashtë muajve nga momenti që bashkëshorti i kanosur apo në lajthim, ka zbuluar lajthimin, apo ka pushuar kanosjen, dhe jo më tepër se tre vjet nga lidhja e martesës.

## **4.2 Parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, risitë e ndryshimeve**

Referuar ndryshimeve të reflektuara në Kodin e Procedurës Penale bazuar në Ligjin nr.35/2017, viktimi e veprës penale tashmë është një subjekt aktiv i procesit penal pasi në bazë të nenit 58/a të tij

gëzon një nga të drejtat themelore: *“të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit”*. Viktimat e dhunës në familje dhe në mënyrë të veçantë avokatët që i përfaqësojnë ato duhet të jenë aktivë në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre në procesin penal.

Subjekti *“viktimë”* ka hapur tepër debat dhe do vazhdojë të ketë, pasi pavarësisht se ne kemi përqaftuar një doktrinë mikse ndërmjet sistemit inkuizitor dhe atij akuzator, në vendin tonë, të drejtën e inicimit të procedimit penal e ka Prokurori, pra akuza në gjykim është përfaqësuar nga Prokurori, me përjashtim *“të dëmtuarit akuzues”* para ndryshimeve K.Pr.P. dhe *“viktimës akuzuese”* pas ndryshimeve të K.Pr.P. e cila ka të drejtën e depozimit të kërkesës për ndjekjen penale të fajtorit drejtpërdrejtë në gjykatë.

**Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.3, datë 06.02.2008 ka argumentuar se:**

***“Si akuza publike ashtu edhe akuza private të parashikuara nga legjislacioni procedural penal janë dy mekanizma që shërbejnë për ndjekjen penale të autorit të veprës penale dhe në asnjë rast ato nuk kanë për qëllim eliminimin e njëra tjetrës. Ato bashkëveprojnë edhe në raste të caktuara gjejnë zbatim veçmas”*<sup>1</sup>**

- *“Arrestimi në burg”* referuar nenit 230 pika 1 K.Pr.P. është një ndër masat e sigurimit personal e cila mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit. Por kjo masë në sistemin gjyqësor është masa më shumë e aplikuar, sidomos në rastin e zbatimit të nenit 130/a apo 79/c K.Pr.P. Referuar nenit 246 pika 6 K.Pr.P. prokurori është subjekti i cili ka detyrimin ligjor për të informuar me shkrim gjykatën

---

<sup>1</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 06/02/2008

që ka caktuar masën e sigurimit rreth mënyrës së zbatimit të vendimit të arrestimit, çdo 2 muaj nga momenti i ekzekutimit të vendimit të arrestit. Për shkak të rëndësisë së veçantë dhe zhvillimit dinamik të veprës penale së “dhunës në familje” duhet të ketë një kontroll periodik çdo 1 muaj nga ana e prokurorit, me qëllim kontrollin e procedurës së zbatimit të vendimit të arrestit. Periudha 1 mujore është më e përshtatshme në rastin e kësaj vepre penale për të verifikuar vijueshmërinë e hetimeve dhe nevojave të sigurimit, këto të fundit mund të kenë gjasa të kenë ndryshuar gjë që sjell revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masës së sigurimit personal.

Sipas nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale (i ndryshuar)

1. Viktima e veprës penale ka të drejtë:

- a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
- b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
- c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;
- ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;
- dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrojë kërkesa të

- tjera përpara organit procedues;
- e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimën e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;
  - ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;
  - f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
  - g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
  - gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;
  - h) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
  - i) të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;
  - j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

Edhe trashëgimtarët e viktimës kanë disa të drejta po sipas të njëjtit nen:

Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara në shkronjat "a", "e", "ë", "f", "g" dhe "j", të paragrafit 1, të këtij neni. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.

Me ligjin nr 35/2017 në Kodin e Procedurës Penale janë shtuar për herë të parë edhe të drejtat e viktimës së mitur, ato të viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore. Të drejtat e viktimës së mitur parashikohen në nenin 58.a të KPr.P.

1. Përveç të drejtave të parashikuara në nenin 58 dhe parashikimeve të tjera të këtij Kodi, si dhe legjislacionin e posaçëm për të miturit, viktima e mitur ka të drejtë:

- a) të shoqërohet nga një person i besuar prej tij;
- b) të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale;
- c) të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.

2. Organi procedues duhet të trajtojë viktimën e mitur të veprës penale duke mbajtur parasysh moshën, personalitetin dhe rrethana të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm.

3. Nëse ekziston mundësia që viktima është e mitur dhe moshë e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur.

4. Viktima e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, biseda regjistrohet me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kritereve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të këtij Kodi. Kur viktima e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedise të përshtatura për të.

### **4.3 Viktima dhe dhunuesi në raport me procesin gjyqësor.**

Shpesh viktimat hezitojnë të dëshmojnë kundër dhunuesve për disa arsye, nga më të shpeshtat janë:

- Viktima mund të jetë objekt i kanosjes apo frikësimit nga dhunuesi.
- Dhunuesi mund të jetë sjellë mirë pas denoncimit të dhunës dhe kjo e bën viktimën të mendojë se ai ka ndryshuar dhe viktima e fal.

- Shpesh viktimat, për shkak të mentalitetit, edukimit, apo formimit kulturor, fajësojnë veten për dhunën e pësuar.
- Viktimat besojnë se nuk do të merret parasysh dëshmia e tyre, edhe për shkak të mosbesimit në sistemin gjyqësor.

### **Efektet që jep dhuna tek viktimat janë si më poshtë:**

- Vetëbesim i ulët.
- Vetëfajësim.
- Stres,
- Tentative vetëvrasese,
- Izolim nga familja dhe miqtë,
- Nënvlleftësim dhe arsyetim i dhunës,
- Frike

Dhuna në familja ka të bëjë me pushtetin dhe kontrollin. Dhuna është një zgjedhje dhe jo një sjellje “jashtë kontrollit”. Zemërimi, përdorimi i alkoolit, është vetëm një justifikim i sjelljes së dhunuesit. Këto faktorë mund të ndikojnë në shkallën e dhunës, por nuk e shkaktojnë atë. Trajtimi nga droga ose alkooli mund të jetë i nevojshëm, por nuk është zgjidhje përfundimtare. Ndërprerja e tyre nuk e ndërpret dhunën në familje.

### **Sjelljet e zakonshme të një dhunuesi konsistojnë në këto veprime:**

- Përpjekje për të kontrolluar viktimën.
- Nënvlleftësim të dhunës.
- Mohim të veprimeve.
- Fajësimi i viktimës.
- Xhelozia dhe ndjenjë pronësie.
- Sjellje të pëlqyeshme në publik, por sjellje krejt të ndryshme ambientin familjar.



- Shprehje keqardhje që nuk e ndiejnë në të vërtetë.
- Premtime të cilat nuk i mbajnë.

#### **4.4 Roli i avokatit, juristit apo gjyqtarit**

Gjykatësi avokati apo juristi duhet të dëgjojë me kujdes. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme për të ndihmuar viktimën të jetë e sigurtë.

Duhet të mbajë një qëndrim aktiv në mënyrë që viktimat të ketë besim tek avokati mbrojtës dhe tek gjykata dhe procesi. Duhet të shpjegojë me kujdes mundësitë dhe të sigurohet që viktimat i kupton ato. Duhet të krijojë një ambient besimi që viktimat të jetë në gjendje të shprehet qartë dhe pa frikë. Duhet të tregojë se nuk ka absolutisht tolerancë për dhunën në familje.

#### **Pyetja e palëve nga avokati, juristi dhe gjykata**

- Lidhja me të paditurin.
- Një historik i shkurtër i marrëdhënieve të palëve
- Çfare veprimesh ka kryer i padituri.
- A ka raste të tjera të dhunës në familje dhe urdhra të mbrojtës të mëparshëm ?
- A është bërë zgjidhja e martesës apo është në proces një gjë e tillë ?
- Kur dhe ku ka ndodhur ngjarja ?
- Kush ka qenë i pranishëm gjatë këtyre veprimeve?
- A ka pasur frikë nga kjo sjellje?
- Përse mendon se ka nevojë për urdhër mbrojtje në të ardhmen?
- Nëse ka persona të tjerë për të cilët kërkohet urdhri i mbrotjes, cila është lidhja me ta? .
- Çfarë ka bërë i padituri kundër tyre, kur dhe ku?
- Nëse kanë fëmijë, kush është kujdestari ligjor?
- Çfarë marrëdhëniesh kanë me të paditurin?

- Çfarë masash kërkon për të miturin dhe a janë në interesin më të lartë të fëmijës?
- 

#### 4.5 Intervistimi i viktimës

**Kujdes! Avokati duhet të sigurojë viktimën në lidhje me privatësinë e procesit duke e intervistuar viktimën në një vend larg syrit dhe veshëve të dhunuesit, dëshimtarëve apo kalimtarëve. Gjatë pyetjeve avokatët rekomandohet të:**

Përdorin teknika mbështetëse.

- Të pyesin viktimën rreth ndonjë ngjarje të mëparshme të dhunës në familje, frekuencën dhe egërsinë,
- Të mos i tregojne viktimës se çfarë veprimesh ai/ajo duhet të ndër marrë derisa i gjithë informacioni i mbledhur të vlerësohet.
- Pyetet viktima dhe i/e dyshuari nëse kanë dhimbje edhe nëse nuk ka plagë të dukshme.
- Dokumentohen kushtet në të cilat gjendet viktima dhe i dyshuari si sjellja e tyre, madhësia e dëmtimit, dhe dëshmi të lëndimit.
- **I jepet siguri viktimës:** sigurohet që viktima nuk do të ketë pasoja pas dhënies së deklaratës dhe pas largimit tënd. Bindet viktima se siguria e saj është prioritet për avokatin dhe se viktima nuk është fajtores.
- **Fitohet besimi i viktimës:** Avokati/Avokatja me veprimet e tij/saj duhet të fitojë besimin e viktimës në mënyrë që të jetë në gjendje të grumbullojë gjithë informacionin dhe faktet e duhura për të vazhduar mbrojtjen e viktimës deri në fund.

**Kujdes:** Ajo që ka ndodhur mund të ketë shkaktuar traumë tek viktimë. Avokatët nuk duhet të harrojnë që krimi, mund të jetë ngjarje rutinë për punën tyre, por jo për viktimën.

- Tregohet kujdes me tonin e zërit, shikimin dhe fjalët e përdorura: të gjitha këto duhet të demonstrojnë se avokati është aty “për të kuptuar se çfarë ka ndodhur dhe për të ndihmuar, jo për të gjykuar”.
- Tregohet vëmendje dhe durim në marrjen e përgjigjeve: mbahet parasysh se viktimës mund t’i jetë thënë nga dhunuesi se, nëse kërkon ndihmë askush nuk do ta dëgjojë.
- Tregohet miresjellje, maturi dhe racionalitet: Është e rëndësishme të tregohet ndjeshmëri maturi dhe seriozitet në trajtimin e rasteve të dhunës në familje.
- Tregohet mbështetje: demonstron me veprime të sjelljeve se për avokatin ka shumë rëndësi siguria e viktimës. Ndihmohet të heqë frikën dhe të jetë gati për të bashkëpunuar. Duhet bërë viktimë që të ndjejë se deklarata e tij/saj është e rëndësishme,
- Duhet kujdes me këshillat që i jepen viktimës:
- Pasi praktika ka evidentuar raste që tregojnë se avokatët kanë këshilluar viktimën të rikthehet në shtëpinë e bashkëshortit ose familjen ku është ushtruar dhunë.

## 5. DHUNA NË FAMILJE NË RAPORT ME NENIN 2 TË KONVENTËS EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE JURISPRUDENCËN E GJYKATËS EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË STRASBURG

---

Sipas nenit 2 KEDNJ e drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Por krahas parimit të përgjithshëm të mbrojtjes absolute të jetës, në pikën 2 të dispozitës është parashikuar përjashtimi, në kontekstin “justifikues”, kur privimi nga jeta vjen nga përdorimi i forcës, që është jo më shumë se absolutisht i domosdoshëm me qëllim përmbushjen e një ndër qëllimeve alternative që janë: *së pari*, mbrojtja e çdo personi nga dhuna e paligjshme; *së dyti*, kryerja e një arrestimi të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të ndaluar ligjërisht dhe *së treti*, për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje. Pavarësisht se trajtimi në këtë ese është parë në këndvështrimin e humbjes së jetës, si pasojë e dhunës në familje kur viktimë kryesisht është femra, GJEDNJ në çështjen **Opuz kundër Turqisë**, ka argumentuar se: *“Çështja e dhunës në familje, e cila mund të formësohet në mënyra të ndryshme nga dhuna fizike tek ajo psikologjike ose abuzimi verbal... është një problem i përgjithshëm që shqetëson të gjitha shtetet anëtare dhe që nuk rezulton gjithmonë në sipërfaqe pasi që shpesh ndodh brenda marrëdhënieve personale ose qarqeve të mbyllura dhe nuk janë vetëm gratë të prekura. Gjykata pranon se meshkujt mund të jenë gjithashtu viktimë të dhunës në familje dhe, në të vërtetë, edhe fëmijët janë shpesh viktimë të fenomenit, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte...”*<sup>2</sup>

Çështja **Tomašić dhe të tjerë kundër Kroacisë**, e përballi Gjykatën

---

<sup>2</sup> Parag.132 i vendimit, Aplikim nr. 33401/02, Strasburg datë 09/06/2009

me aplikimin e drejtuar nga të afërmit e një fëmije dhe nënës së tij, të dy viktimat të ekzekutuar nga babai/bashkëshorti, i cili gjithashtu ishte vetëvrarë, një muaj pas lirit të tij nga burgu. Arsyeja e qëndrimit në burg të këtij individ rezultonte të ishte kallëzimi i bërë nga viktimat si pasojë e kërcënimeve të vazhdueshme me vdekje të drejtuara kundrejt saj. Sipas aplikantëve, shteti kroat kishte dështuar në marrjen e masave adekuate për të mbrojtur fëmijën dhe nënën e tij dhe nuk kishte kryer një hetim efektiv mbi përgjegjësinë e mundshme të shtetit për vdekjet e të afërmit të tyre. Bazuar në rrethanat faktike, vlerësohet e mjaftueshme për Gjykatën për të gjetur shkelje të aspektit substancial të nenit 2 KEDNJ, dështimi i autoriteteve përkatëse vendase për të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme dhe të arsyeshme në rrethanat e rastit aktual për të ofruar mbrojtje për jetën e dy viktimave. Referuar gjetjeve të sistemit të brendshëm gjyqësor dhe përfundimeve të ekzaminimeve psikiatrike u vu në dukje se autoritetet kishin qenë të vetëdijshëm se kërcënimet e bëra kundër jetës së nënës dhe fëmijës ishin serioze (kërcënime të bëra dhe gjatë seancave gjyqësore ku viktimat kishin qenë të pranishme) dhe se të gjitha hapat e arsyeshëm duhet të ishin ndërmarrë për t'i mbrojtur. Gjykata më tej vuri në dukje disa mangësi në sjelljen e autoriteteve: megjithëse raporti psikiatrik i hartuar për qëllimet e procedurës penale kishte theksuar nevojën për trajtimin e vazhdueshëm psikiatrik të të dënuarit, qeveria kroate nuk kishte arritur të provonte se një trajtim i tillë ishte administruar siç duhej; dokumentet e paraqitura treguan se trajtimi i të dënuarit në burg ishte i përbërë nga seanca bisedimesh me stafin e burgjeve, asnjë prej të cilëve nuk ishte psikiatër; as rregulloret përkatëse, as argumentimi i gjykatës që urdhëron trajtimin e detyrueshëm psikiatrik nuk kishin dhënë

detaje të mjaftueshme se si do të administrohej trajtimi; dhe së fundi, i dënuari nuk i ishte nënshtruar një vlerësimi para lirimit të tij nga burgu për të vlerësuar nëse ai ende përbënte rrezik për fëmijën dhe nënën e tij.<sup>3</sup>

Çështja ***Civek kundër Turqisë***, vjen e trajtuar në kuadrin e një sërë çështjesh të marra në shqyrtim nga ana e GJEDNJ-së ndaj një shteti ku dhuna në familje është shqetësuese, siç është Turqia. Në rolin e kërkuarit qëndron i biri i viktimës së ekzekutuar nga bashkëshorti i saj (babai i kërkuarit). Që nga viti 2009, viktimja banonte me tre fëmijët e saj në një qendër sociale pranimit për gratë e dhunuara, pasi si pasojë e ankesës së saj, bashkëshorti i saj u arrestua dhe u akuzua për shkakim të dëmit trupor ndaj saj. Por kjo e fundit, në Dhjetor 2010 tërhoqi ankesën e saj duke sjellë si rrjedhojë lirimin e menjëhershëm të dhunuesit, lirim i shoqëruar me një masë gjyqësore mbikëqyrjeje (duke konsistuar në paraqitjen para organeve policore në ditët dhe oraret e përcaktuara) dhe shmangien e çdo sjellje të dhunshme ose kërcënuese ndaj bashkëshortes së tij, si dhe detyrimin për t'u larguar menjëherë nga banesa martesore për një periudhë 3 mujore. Pas 11 ditësh pas lirimit të dhunuesit, nëna e kërkuarit paraqiti përsëri ankime ndaj bashkëshortit të saj, i cili tashmë e kishte kërcënuar me vdekje. Policia vetëm regjistroi ankimin e nënës së kërkuarit dhe nuk mori asnjë masë për arrestimin e dhunuesit, derisa gruaja u vra në rrugë nga bashkëshorti i saj, i cili e qëlloi atë me thikë 22 herë. Gjykata në mënyrë unanime vendosi se Turqia kishte shkelur nenin 2 të KEDNJ, duke arsyetuar se në varësi të informimit të vazhdueshëm nëpërmjet ankesave të bëra nga nëna e kërkuarës dhe dëshmimeve të kërkuarësve, autoritetet shtetërore përfaqësuar

---

<sup>3</sup> Parag. 52 e vijues të vendimit, Aplikim nr.46598/06, Strasburg datë 15/01/2009

nga policia ishin në dijëni ose duhej ta dinin se e dhunuara mund të ishte objekt i një sulmi vdekjeprurës. Megjithëse autoritetet morën disa masa, ata nuk morën masat e mjaftueshme efektive për të parandaluar vrasjen. Pas marrjes së ankesës në një hark kohor të shkurtër, policia vetëm regjistroi ankimin tjetër nga viktimja pa marrë asnjë masë praktike dhe konkrete për të mbrojtur efektivisht nënën e kërkuesve. Autoritetet mund të kishin arrestuar ligjërisht bashkëshortin për mosrespektim të urdhrave të gjykatës.<sup>4</sup>

Në çështjen **Talpis kundër Italisë**, Gjykata u përball në muajin Mars të vitit 2017 me dhunën bashkëshortore të pësuar nga kërkuesia, e cila rezultoi me vrasjen e djalit të saj dhe tentativën për vrasjen e saj. Sipas kërkueses që nga viti 2012, bashkëshorti i alkoolizuar e dhunonte fizikisht, situatë për të cilën kishte vënë në dijëni dhe autoritetet policore, por pas ekzaminimeve mjekësore policët e zonës e informuan kërkuesen që të paraqitej pranë shërbimit spitalor të urgjencës dhe askush nuk e informoi mbi mundësinë e paraqitjes së kallëzimit apo kontaktit me qendrën për viktimat e dhunës në familje. Sulmi i dytë ndaj kërkueses çoi sërisht në informimin e policisë prej saj, por përsëri pa asnjë reagim nga ana e këtyre të fundit. Më 18 Nëntor 2013, vjen dhe episodi i tretë i dhunës ku nga sulmi mbeti i vdekur dhe fëmija (djali) i aplikantes dhe dhunuesit. Gjykata gjeti shkelje të nenit 2 të Konventës, pasi autoritetet italiane dështuan në përmbushjen e detyrimit të tyre pozitiv të përcaktuar në Konventë. *“Autoritetet me incerinë dhe indiferencën e tyre kanë krijuar hapësirë për ardhjen e pasojave, pasi ata e kanë vënë re në mënyrë të përsëritur dhunën e bashkëshortit, por nuk kanë marrë masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të mbrojtur jetën e kërkueses dhe atë të djalit të saj kundër rrezikut të*

---

<sup>4</sup> Aplikim nr.55354/11, Strasburg datë 23/02/2016

*vërtetë dhe të njohur*".<sup>5</sup>

Gjykata në qëndrimin e mbajtur në praktikën e saj referuar rasteve të dhunës në familje në mënyrë të qartë ka ritheksuar se fëmijët dhe kategoritë vulnerabël, në veçanti kanë të drejtën e mbrojtjes nga ana e shtetit në formën e parandalimit efektiv, duke synuar mbrojtjen e tyre nga format po aq serioze të veprave penale të cilat kanë si qëllim cënimin e integritetit të personit. **Rrethi i organeve dhe institucioneve përgjegjës është tepër i gjerë, por detyrimi pozitiv që vetë neni 2 i Konventës reflekton synon krijimin e një sistemi gjyqësor efektiv dhe të pavarur që do të mundësojë identifikimin e shkaktarit vrasës së individit dhe ndëshkimin e autorit.** Në kuadrin e veprimtarisë së autoriteteve shtetërore, konkretisht autoriteteve të vijës së parë siç është policia, duhet të ofrohet siguri për zbatimin me rigorizitet nga ana e tyre të parashikimeve ligjore, duke nënkuptuar domosdoshmërinë e një "diligjence" të arsyeshme. Por qëllimi i detyrimit pozitiv në frymën e Konventës nuk mund të jetë absolut, pasi nuk mund t'u imponohet autoriteteve shtetërore një barrë e tepruar për të ushtruar funksionet e tyre legjitime në një shoqëri bashkëkohore, përballë një reagimi njerëzor të paparashikueshëm apo zgjedhjeve operacionale të zbatuara sipas një plani të paracaktuar. Si rrjedhojë, çdo kërcënim i mundshëm i jetës nuk i detyron autoritetet për të marrë masa konkrete për parandalimin e tij, përveç rasteve kur kërcënimi është objektiv dhe autoritetet kanë dijeni ose duhej të kishin dijeni se në të vërtetë një individ i caktuar është shënjestër e tij dhe se brenda kompetencave të autoriteteve masat e marra nga ana e tyre, nga një këndvështrim i arsyeshëm, padyshim që do të sjellin neutralizimin e kësaj situatë.

---

5 Parag.76 i vendimit, Aplikimi nr.41237/14, Strasburg datë 02/03/2017



## **ANEKS 1**

### **KËRKESË-PADI PËR LËSHIMIN E URDHIMIT TË MBROJTJES**

---

1. DREJTUARGJYKATËSSËRRETHITGJYQËSOR \_\_\_\_\_  
(Emri dhe adresa e gjykatës së rrethit) Nr. i KËRKESË-PADISË/  
ÇËSHTJES: \_\_\_\_\_
2. PADITËSI/JA1 kundër
3. I PADITURI/E PADITURA
4. Shënoni emrin dhe adresën e viktimës/ave nëse është i  
ndryshëm nga emri i paditësit (emri, atësia dhe mbiem-  
ri) \_\_\_\_\_
5. SHËNIM: Nëse duke dhënë adresën keni frikë për sigurinë tuaj  
apo të njerëzve të tjerë nën përgjegjësinë tuaj, ju lutem jepni  
më poshtë një adresë tjetër të cilën dëshironi ta përdorni për  
qëllime të procesit gjyqësor:

Adresa: \_\_\_\_\_

Numri i telefonit: \_\_\_\_\_

Të dhëna të tjera kontakti: \_\_\_\_\_

6. Objekti i kërkesë padisë: Lëshimi i urdhimit të mbrojtjes
7. Kuadri ligjor: Ligji nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006, "Për masa ndaj  
dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.
8. Shpjegoni marrëdhënien e viktimës me të paditurin/ën (sipas  
shënimit të mëposhtëm): Viktima është \_\_\_\_\_ i të  
paditurit/e të paditurës. SHËNIM: Pjesëtarët e familjes janë (a)  
Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja; apo ish-bashkëshorti/ja  
apo ish partneri/ja bashkëjetues; (b) Vëllezërit, motrat, gjinia  
në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e  
adoptuar; (c) Bashkëshortët e personave të mësipërm; (d) Gjinia

në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es; (e) Vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 (tre) muajve të fundit; (f) Fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.

9. Të dhëna të mëtejshme për viktimën:
10. Të dhëna të mëtejshme për të paditurin/ën:
11. Procese të tjerë ku janë të përfshirë viktimat apo fëmijët e tyre dhe i padituri/e paditura:
12. Faktet dhe rrethanat. Shpjegoni në mënyrë të qartë e të kujdesshme faktet dhe rrethanat e incidenteve të dhunës në marrëdhëniet familjare midis viktimës dhe të paditurit/ës (nëse është e nevojshme shtoni fletë të tjera):

Incidenti nr. 1 Data: \_\_\_\_\_

Vendi i incidentit: \_\_\_\_\_

Veprimi apo mosveprimi : \_\_\_\_\_

Kundër kujt (rendisni): \_\_\_\_\_

Efektet mbi viktimën/viktimat(rendisni): \_\_\_\_\_

Përshkrim i mëtejshëm i incidentit: \_\_\_\_\_

Njërez të pranishëm gjatë incidentit (rendisni): \_\_\_\_\_

Incidenti nr. 2 Data: \_\_\_\_\_

Vendi i incidentit: \_\_\_\_\_

Veprimi apo mosveprimi : \_\_\_\_\_

Kundër kujt (rendisni): \_\_\_\_\_

Efektet mbi viktimën/viktimat(rendisni): \_\_\_\_\_

Përshkrim i mëtejshëm i incidentit: \_\_\_\_\_

Njërez të pranishëm gjatë incidentit (rendisni): \_\_\_\_\_

Incidenti nr. 3 Data: \_\_\_\_\_  
Vendi i incidentit: \_\_\_\_\_  
Veprimi apo mosveprimi : \_\_\_\_\_  
Kundër kujt (rendisni): \_\_\_\_\_  
Efektet mbi viktimën/viktimat(rendisni): \_\_\_\_\_  
Përshkrim i mëtejshëm i incidentit: \_\_\_\_\_  
Njëri të pranishëm gjatë incidentit (rendisni): \_\_\_\_\_  
13. Jepni arsyet për ta bërë të qartë dëmin që i është shkaktuar  
sigurisë, shëndetit apo mirëqënies së viktimës: \_\_\_\_\_  
14. Prova: (rendisni këtu prova mbështetëse dhe bashkëngjijtani  
dokumentet përkatës kësaj kërkesë)  
Numri i çështjes në polici \_\_\_\_\_  
Kopje e raportit të policisë \_\_\_\_\_  
Raporti mjekësor \_\_\_\_\_  
Akti i ekspertizës mjeko-ligjore \_\_\_\_\_  
Vërtetime nga qendrat sociale dhe të rehabilitimit për viktimat  
(rendisni): \_\_\_\_\_  
Vlerësimi i ekspertëve (rendisni): (p.sh., psikologu, specialisti i  
kafshëve shtëpiake etj.) \_\_\_\_\_  
Deklaratat e dëshmitarëve (rendisni): \_\_\_\_\_  
Prova të tjera (rendisni): (p.sh., ditari i viktimës, vizatime të fëmijëve,  
fotografi të dëmtimeve, komunikimi me postë elektronike, SMS,  
regjistrime në kasetë etj.) \_\_\_\_\_  
15. Paditësi i kërkon gjykatës të lëshojë urdhër mbrojtjeje për  
personat e mëposhtëm:  
Emri \_\_\_\_\_  
Data e lindjes \_\_\_\_\_  
Marrëdhënia me të paditurin/ën \_\_\_\_\_

16. Paditësi/paditësja i kërkon gjykatës që në urdhrin e saj të mbrojtjes të lëshojë masat e mëposhtme: (nëse janë të zbatueshme, mund të zgjidhni më shumë se një alternativë) \_\_  
\_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të mos kryejë veprë të dhunës në familje ndaj (emrat) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të mos kërcënojë (emrat) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të mos cenojë, ngacmojë apo kontaktojë me (emrat) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të largohet nga banesa (adresa) \_\_\_\_\_ për një kohë prej (shënoni kohën) \_\_\_\_\_ dhe të mos lejohet të rihyjë pa autorizimin e gjykatës.

I padituri/e paditura të mos u afrohet personave të përmendur më sipër përtej një distance prej \_\_\_\_\_ (shënoni distancën). \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të mos shkojë në:

• shkollën e (emri): \_\_\_\_\_, (adresa) \_\_\_\_\_

• kopshtin e (emri): \_\_\_\_\_, (adresa) \_\_\_\_\_

• vendin e punës së (emri): \_\_\_\_\_, (adresa) \_\_\_\_\_

• banesën e (emri): \_\_\_\_\_, (adresa) \_\_\_\_\_

Të vendosë personat e mëposhtëm në: (strehëz/banesë e përkohëshme) nën përgjegjësinë e (emri i organizatës /autoritetit) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të kontaktojë (emri i fëmijës) \_\_\_\_\_ vetëm (kur, dita e javës, afatet kohorë) në (vendin) \_\_\_\_\_

ose me anë të (mënyrat e kontaktimit) \_\_\_\_\_

Të ndalojë hyrjen dhe ndënjën e të paditurit/ paditurës në banesën e (emri) \_\_\_\_\_

në \_\_\_\_\_ (adresën) \_\_\_\_\_

Të autorizojë (pozicioni/autoriteti) \_\_\_\_\_ që të shoqërojë (cilin) \_\_\_\_\_

në banesën e viktimës dhe të shoqërojë lëvizjen e sendeve të tyre personale \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të dorëzojë të gjitha armët në (emri i institucionit/oficerit) \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të lejojë paditësin/paditësen të zotërojë banesën e përbashkët në adresën: \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura t'i paguajë (emri i personit) \_\_\_\_\_ sasinë mujore prej \_\_\_\_\_ për pagesë në qirasë \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura t'i paguajë (emri i personit) \_\_\_\_\_ sasinë mujore prej \_\_\_\_\_ si detyrim për të mbështetur personat e përmendur më sipër \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të mos lejohet të asgjësojë pasurinë bashkëshortore \_\_\_\_\_

Të paditurit/paditurës t'i hiqet përgjegjësia mbi fëmijët (emrat): \_\_\_\_\_

T'i jepet paditësit/ses përkohësisht e drejta e kujdestarisë mbi fëmijët (emrat) \_\_\_\_\_

Të urdhërohen shërbimet sociale (emrat) \_\_\_\_\_ që t'u sigurojnë shërbimet e mëposhtme përsonave të sipërpërmendur (rendisni shërbimet që do viktimat) \_\_\_\_\_

Të urdhërohet i padituri/epadituraqët'ipaguajë periodikisht (saktëso periudhën) \_\_\_\_\_ (shumën) \_\_\_\_\_ (kujt) \_\_\_\_\_

OSE të urdhërohet i punësuari i të paditurit/ës (emri) \_\_\_\_\_ që t'i derdhë periodikisht (saktëso periudhën) \_\_\_\_\_ (shumën) \_\_\_\_\_ (kujt) \_\_\_\_\_ Futja e viktimës në programe rehabilituese \_\_\_\_\_

Të urdhërohet dhunuesi/ja të marrë pjesë në programe rehabilitimi dhe këto programe të urdhërohen të raportojnë çdo javë në gjykatë nëse dhunuesi/ja e ndjek apo merr pjesë në të.

17. Kohëzgjatja e urdhrit mbrojtës \_\_\_\_\_

Emri i paditësit: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i paditësit: \_\_\_\_\_

Emri i përfaqësuesit: \_\_\_\_\_ (nëse ka)

Nënshkrimi i përfaqësuesit: \_\_\_\_\_

## **ANEKS 2**

### **KËRKESË-PADI PËR LËSHIMIN E URDHIMIT TË MENJËHERSHËM TË MBROJTJES**

---

1. DREJTUAR GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR \_\_\_\_\_  
(Emri dhe adresa e gjykatës së rrethit) Nr. i KËRKESË-PADISË /  
ÇËSHTJES: \_\_\_\_\_

2. PADITËSI/JA11 kundër

3. I PADITURI/ E PADITURA

4. Shënoni emrin dhe adresën e viktimës/ave nëse është i ndryshëm nga emri i paditësit (emri, atësia dhe mbiemri) \_\_\_\_\_

5. SHËNIM: Nëse duke dhënë adresën keni frikë për sigurinë tuaj apo të njerëzve të tjerë nën përgjegjësinë tuaj, ju lutem jepni më poshtë një adresë tjetër, të cilën dëshironi ta përdorni për qëllime të procesit gjyqësor: Adresa: \_\_\_\_\_  
Numri i telefonit: \_\_\_\_\_ Të dhëna të tjera kontakti: \_\_\_\_\_

6. Objekti i kërkesë-padisë: Lëshimi i urdhimit të menjëherëshëm mbrojtës.

7. Kuadri ligjor: Ligji nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.

8. Shpjegoni marrëdhënien e viktimës me të paditurin/ën (sipas shënimit të mëposhtëm): Viktima është \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ i të paditurit/ e të paditurës.

SHËNIM: Pjesëtarët e familjes janë (a) Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja; apo ish bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues; (b) Vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar; (c) Bashkëshortët

e personave të mësipërm; (d) Gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es; (e) Vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 (tre) muajve të fundit; (f) Fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.

9. Të dhëna të mëtejshme për viktimën:

10. Të dhëna të mëtejshme për të paditurin/ën:

11. Procese të tjerë ku janë të përfshirë viktimat apo fëmijët e tyre dhe i padituri/e paditura:

12. Faktet dhe rrethanat. Shpjegoni në mënyrë të qartë e të kujdesshme faktet dhe rrethanat e incidenteve të dhunës në marrëdhëniet familjare midis viktimës dhe të paditurit/ës (nëse është e nevojshme shtoni fletë të tjera):

Incidenti nr. 1 Data: \_\_\_\_\_

Vendi i incidentit: \_\_\_\_\_

Veprimi apo mosveprimi : \_\_\_\_\_

Kundër kujt (rendisni): \_\_\_\_\_

Efektet mbi viktimën/viktimat(rendisni): \_\_\_\_\_

Përshkrim i mëtejshëm i incidentit:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Njërëz të pranishëm gjatë incidentit (rendisni):

\_\_\_\_\_



\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Incidenti nr. 2 Data: \_\_\_\_\_

Vendi i incidentit: \_\_\_\_\_

Veprimi apo mosveprimi : \_\_\_\_\_

Kundër kujt (rendisni): \_\_\_\_\_

Efektet mbi viktimën/viktimat(rendisni): \_\_\_\_\_

Përshkrim i mëtejshëm i incidentit: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Njërëz të pranishëm gjatë incidentit (rendisni): \_\_\_\_\_

Incidenti nr. 3 Data: \_\_\_\_\_

Vendi i incidentit: \_\_\_\_\_

Veprimi apo mosveprimi : \_\_\_\_\_

Kundër kujt (rendisni): \_\_\_\_\_

Efektet mbi viktimën/viktimat(rendisni): \_\_\_\_\_

Përshkrim i mëtejshëm i incidentit: \_\_\_\_\_

13. Jepni arsyet për ta bërë të qartë dëmin që i është shkaktuar sigurisë, shëndetit apo mirëqënies së viktimës: \_\_\_\_\_

14. Prova: (rendisni këtu prova mbështetëse dhe bashkëngjijtani dokumentet përkatës kësaj kërkesë)

Numri i çështjes në polici \_\_\_\_\_

Kopje e raportit të policisë \_\_\_\_\_

Raporti mjekësor \_\_\_\_\_

Akti i ekspertizës mjeko-ligjore \_\_\_\_\_

Vërtetime nga qendrat sociale dhe të rehabilitimit për viktimat (rendisni): \_\_\_\_\_

Vlerësimi i ekspertëve (rendisni): (p.sh., psikologu, specialisti i kafshëve shtëpiake etj.) \_\_\_\_\_

Deklaratat e dëshmitarëve (rendisni): \_\_\_\_\_

Prova të tjera (rendisni): (p.sh., ditari i viktimës, vizatime të fëmijëve, fotografi të dëmtimeve, komunikimi me postë elektronike, SMS, regjistrime në kasete etj.)

15. Padiësi i kërkon gjykatës të lëshojë urdhër mbrojtjeje për personat e mëposhtëm:

Emri \_\_\_\_\_

Data e lindjes \_\_\_\_\_

Marrëdhënia me të paditurin/ën \_\_\_\_\_

16. Padiësi/padiësja i kërkon gjykatës që në urdhrin e saj të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshojë masat e mëposhtme: (nëse janë të zbatueshme, mund të zgjidhni më shumë se një alternativë) \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të mos kryejë vepër të dhunës në familje ndaj (emrat) \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të mos kërcënojë (emrat) \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të mos cenojë, ngacmojë apo kontaktojë me (emrat) \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të largohet nga banesa (adresa) \_\_\_\_\_ për një kohë prej (shënoni kohën) \_\_\_\_\_ dhe të mos lejohet të rihyjë pa autorizimin e gjykatës. \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të mos u afrohet personave të përmendur më sipër përtej një distance prej \_\_\_\_\_ (shënoni distancën). \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të mos shkojë në:

• shkollën e (emri): \_\_\_\_\_, (adresa) \_\_\_\_\_

- kopshtin e (emri): \_\_\_\_\_, (adresa) \_\_\_\_\_
- vendin e punës së (emri): \_\_\_\_\_, (adresa) \_\_\_\_\_
- banesën e (emri): \_\_\_\_\_, (adresa) \_\_\_\_\_

Të vendosë personat e mëposhtëm në: (strehëz/banesë e përkohëshme) \_\_\_\_\_

nën përgjegjësinë e (emri i organizatës /autoritetit) \_\_\_\_\_

I padituri/e paditura të kontaktojë (emri i fëmijës) \_\_\_\_\_ vetëm (kur, dita e javës, afatet kohorë) në (vendin) \_\_\_\_\_ ose me anë të (mënyrat e kontaktimit) \_\_\_\_\_

Të ndalojë hyrjen dhe ndënjën e të paditurit/ paditurës në banesën e (emri) \_\_\_\_\_ në (adresën) \_\_\_\_\_

Të autorizojë (pozicioni/autoriteti) \_\_\_\_\_

që të shoqërojë (cilin) \_\_\_\_\_ në banesën e viktimës dhe të shoqërojë lëvizjen e sendeve të tyre personale.

I padituri/e paditura të dorëzojë të gjitha armët në (emri i institucionit/oficerit)

17. Kohëzgjatja e urdhrit të menjëhershëm mbrojtës \_\_\_\_\_

Emri i paditësit: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i paditësit: \_\_\_\_\_

Emri i përfaqësuesit: \_\_\_\_\_ (nëse ka)

Nënshkrimi i përfaqësuesit: \_\_\_\_\_

## LITERATURA DHE BAZA LIGJORE

---

Policimi dhe Siguria Dhuna Ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, botim i Akademisë së Sigurisë Tiranë 2018.

“Dhuna ne familje dhe policia e Shtetit Shqiptar”, Studim nga Instituti Studimor Data Centrum mbështetur nga Mbështetja Suedeze për MB dhe PSH për Policimin në Komunitet, Tiranë. (Tetor 2012).

Nacro (2002) ‘Access All Areas - A Guide for Community Safety Partnerships on Working Effectively with Disabled People’, Crime and Social Policy Section, London.

“Practioners’ guide to domestic abuse” Manual. Bracknell Forest, Royal Borough of Windsor and Maidenhead, Slough. (May 2011).

Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” [Ligji Nr. 104/2012].

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20.11.1989.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (e përditësuar).

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë [Ligji Nr.7895, date 27.1.1995 / ndryshuar] Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë [Ligji Nr.9062, date 8.5.2003/ ndryshuar] Kodi Civil shqiptar [Ligji Nr. 7850, date 29.7.1994].

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë [Ligji Nr.7905,

date 21.3.1995/ i ndryshuar] Kodi i Procedurës Civile [Ligji Nr.8116, date 29.3.1996/ i ndryshuar].

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, i ndryshuar "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

Ligji nr 10329 datë 30.09.2010: Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 9669 dt 18.12.2006.

Ligji nr.10 347, date 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijeve". Vendime të gjykatës së Strasburgut.

Ligji nr 10221 date 04.02.2010 Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Ligji nr. 9749, date 04.06.2007 "Për policinë e shtetit".

Ligji nr.8677, date 02.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore" i ndryshuar.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.334, datë 17.2.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 265, datë 12.04.2012 "Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijeve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij".

Vendimi nr.42, datë 23.02.2011 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

Vendimi nr.1169/16.09.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Urdhri Nr.15 i Ministrit të Shëndetësisë, datë 24.01.2008 "Për trajtimin mjekësor në institucionet shëndetësore publike të personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare".

Urdhri Nr.14 i MSH datë.23.01.2008 për "Evidentimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, në regjistrin dhe në kartelën individuale për viktimat e dhunës në familje".

Urdhri Nr.13 i MSH, datë 23.01.2008 "Për pajisjen e personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare me raportin mjekësor përkatës".

